

Vendim nr. 335, datë 24.12.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 24.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (H) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HARIS GEGA**, përfaqësuar nga avokat Amet Krasniqi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 936, datë 06.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.**

Shfuqizimi i vendimeve nr. 3145, datë 11.07.2024; nr. 00-2025-2959, datë 09.07.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilat është vendosur dhe më pas është lënë në fuqi pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 936, datë 06.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Rivendosja e së drejtës së paditësve për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit gjyqësor nr. 936, datë 06.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 6**

pika 1, 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) si dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, së bashku me djalin dhe prindërit e tij i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, për shkak të humbjes së jetës së vajzës, si pasojë e kontaktit me energjinë elektrike. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 257, datë 21.02.2020, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (*OSHEE*), t'i paguajë kërkuesit dhe familjarëve të tij dëmin pasuror dhe jopasuror, gjithsej 42.905.216 lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë shumë, nga data e depozitimit të padisë në gjykatë më 10.09.2019, deri në datën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me normën bazë të interesit për depozitat, të aplikuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Me vendimin nr. 936, datë 06.12.2023, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke ndryshuar masën e shpërblimit të dëmit vetëm për prindërit e kërkuesit (gjyshërit e së ndjerës), si dhe duke vendosur detyrimin e OSHEE-së, t'i paguajë kërkuesit dhe familjarëve të tij dëmin pasuror dhe jopasuror, gjithsej 39.986.108 lekë, si dhe kamatëvonesat për këtë shumë, nga data e depozitimit të padisë në gjykatë më 10.09.2019, deri në datën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me normën bazë të interesit për depozitat, të aplikuar nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, ajo gjykatë ka urdhëruar shërbimin përmbartimor për ekzekutimin e vendimit si titull ekzekutiv.

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs OSHEE-ja, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, e cila, me kërkesë të paraqitur veçmas, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3145,

datë 11.07.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga Avokatura e Shtetit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

4. Në datën 08.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar revokimin e vendimit nr. 3145, datë 11.07.2024 të sipërcituar. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 00-2025-2959, datë 09.07.2025, ka vendosur mospranimin e kërkesës së revokimit.

5. Në datën 14.10.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 24.10.2025.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi pezullimi i ekzekutimit nga Gjykata e Lartë, i vendosur pa afat dhe pa kriteret të qarta, ka cenuar parimin e proporcionalitetit dhe parimin e barazisë së palëve në proces. Ajo gjykatë nuk ka balancuar interesat e palëve, duke i dhënë përparësi interesit ekonomik të subjektit shtetëror, OSHEE, megjithëse pamundësia financiare nuk përbën justifikim për mosekzekutimin në rastin e një organi shtetëror.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuetit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim,

mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

8. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës. Lidhur me këtë kriter, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose të korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se përmes ankimit kushtetues individual kërkuesi kundërshton në Gjykatë vendimin e Gjykatës së Lartë me të cilin është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, si dhe vendimin për mospranimin e kërkesës për revokimin e tij, duke ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit.

11. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nuk është përfundimtar për efekt të kontrollit kushtetues dhe se kërkuesi i ka të gjitha mundësitë që pretendimet me natyrë kushtetuese t’i paraqesë përpara Gjykatës së Lartë gjatë procesit civil të themelit dhe, më pas, t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Po kështu, nuk rezulton që vendimi i Gjykatës së Lartë, në mënyrë autonome, t’i ketë shkaktuar kërkuesit dëm në ndonjë prej të drejtave të tij kushtetuese, që nuk mund të riparohet gjatë gjykit të themelit të çështjes. Për më tepër, sipas vendimit të gjykatës së apelit, kamatëvonesat do të llogariten mbi

shumën e akorduar si shpërblim dëmi nga data e depozitimit të padisë në gjykatë, më 10.09.2019, deri në datën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me normën bazë të interesit për depozitat të aplikuar nga Banka e Shqipërisë. Për rrjedhojë, Kolegji konstaton se nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

12. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.